

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2435/16 Prot.

Durrës, më 24.10.2025

V E N D I M

Nr. 128, datë 24.10.2025

PËR

**"MIRATIMIN E FORMATIT TË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË
CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË "SHKENCA NDËRKOMBËTARE DHE
DIPLOMATIKE", TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE - JURIDIKE,
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Udhëzimin Nr.10, datë 30.02.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 21.06.2022 dhe Udhëzimin Nr.19, datë 31.08.2023; në Urdhërin e MAS Nr. 323, datë 29.06.2023 "Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga Bachelor në "Shkenca Politike", në Bachelor në "Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomatiqe", të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, me Universitetin e Gjenovës, Itali"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; si dhe referuar relacionit Nr. 1161/3 prot., datë 21.10.2025 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 24.10.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e formatit të diplomës për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomatiqe", të Fakultetit të Shkencave Politike - Juridike, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim t'i përcillet Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njësisë Kryesore i Fakultetit të Shkencave Politike - Juridike
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

